SOS FSHATRAT E FËMIJËVE KOSOVË

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë në kuadër të projektit "*Përforcimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë përmes avansimit të shërbimeve ndaj kujdesit për fëmijët pa kujdes prindëror dhe mbrojtjen e fëmijëve të cënueshëm dhe në rrezik e të qenit në situatë rruge*" i bashkëfinancuar nga UNICEF dhe zyra e BE-së në Kosovë, shpall:

THIRRJE PËR APLIKIM PËR TRAJNIMIN PËR TRAJNER

Ftohen të aplikojnë të interesuarit të cilët kanë njohuri dhe përvojë nga fusha e shërbimeve sociale dhe familjare, për të ndjekur një trajnim për t'u bërë trajnerë **të modulit:**

"**Format e mbrojtjes dhe llojet e shërbimeve sociale**", i cili përmban katër nënmodulet: Strehimi familjar, Adoptimi, Strehimi rezidencial dhe Kujdestaria.

Trajnimet do të përfshijnë pjesën teorike dhe praktike të formave të mbrojtjes së fëmijëve dhe llojet e shërbimeve sociale, ku do shtjellohen katër nënmodulet e përmendura, ndërlidhja e formave të mbrojtjes me njëra tjetrën, aplikim të shkathtësive këshilluese dhe teknikat për referim të rasteve, bazuar në kornizën ligjore vendore dhe ndërkombëtare. Modulet pritet të përdoren si një mjet për rritjen e kapaciteteve të profesionistëve të mbrojtjes sociale nga sektori publik dhe joqeveritar në zbatimin e udhëzimeve administrative dhe ligjeve në fuqi sa i përket formave të mbrojtjes së fëmijëve siq është strehimi familjar, adoptimi, strehimi rezidencial, dhe kujdestaria.

Në fund të procesit, pritet që kandidatët të jenë në gjendje të mbajnë vetë trajnimet për këtë modul me këto nënmodule për profesionistët e shërbimeve sociale në të gjithë Kosovën, duke përdorur materialet e ofruara nga ky trajnim hyrës i trajnerëve. Kandidatët duhet të kalojnë një provim, pas të cilit do të jenë trajnerë të certifikuar zyrtarisht për këtë modul nga KPSHSF.

Kohëzgjatja dhe koha e mbajtjes së trajnimeve

Programi i trajnimit për trajnerë do të zgjasë gjashtë (6) ditë dhe është i ndarë në tri pjesë sipas nënmoduleve të përcaktuara. Nënmoduli i parë dhe i dytë: *Strehimi familjar dhe adoptimi,* do të zgjasë dy (2) ditë dhe tentativisht do të mbahet në datat **06-07 Shkurt 2023**. Nënmoduli i dytë: *Strehimi rezidencial,* do të zgjasë dy (2) ditë dhe tentativisht do të mbahet në datat **13-14 Shkurt 2023**. Nënmoduli i tretë: *Kujdestaria,* do të zgjasë dy (2) ditë dhe tentativisht do të mbahet në datat **23-24 Shkurt 2023**. **Trajnerët duhet të marrin pjesë në të gjitha sesionet për t'u çertifikuar si trajner në modulin përkatës.**

Aplikacionet vlerësohen në bazë të kritereve si në vijim:

Numri i kandidatëve që do të përzgjidhen për të vijuar trajnimin është i limituar.

- Arsimimi dhe kualifikimi profesional në njërën nga këto fusha Punë Sociale, Psikologji, Juridik, Sociologji, Pedagologji, minimumi i kualifikimit Bachelor;
- Së paku dy (2) vite përvojë pune në lidhje me ofrimin e shërbimeve sociale; dhe
- Çertifikimi si trajner dhe përvoja në ofrimin e trajnimeve do të jetë përparësi.

Procesi i aplikimit

Afati kohor për dorëzimin e aplikacioneve është: **30.01.2023 në mesnatë**. Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë vetëm **CV** dhe një **letër motivimi përmes së cilës** kandidati shpjegon se si i plotëson kriteret dhe motivimin e tyre për t'u bërë trajner **(**deri në **250 fjalë**) në mënyrë elektronike në gjuhën shqipe, në e-mail adresën: info@soskosova.org dhe gonxhe.dobroshi@soskosova.org. Të gjitha kualifikimet dhe dëshmitë e përmendura në CV tuaj mund të kërkohen për verifikim. Kandidatët do të zgjidhen në bazë të kritereve të lartpërmendura nga një Komision Përzgjedhës i përbërë nga stafi i SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë dhe KPSHFS-së.